



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE

Nr. 3449 prot.

Himarë, më 13.05 .2026

## **NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE PËR POZICIONIN INSPEKTOR I POLICISË BASHKIAKE, NË DREJTORINË E POLICISË BASHKIAKE**

Në zbatim të ligjit nr. 89/2022, “Për policinë bashkiake”, vendimit nr. 452, datë 26.07.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullorës kuadër të policisë bashkiake”, si dhe vendimit nr. 4, datë 17.02.2026, të Kryetarit të Bashkisë Himarë “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Himarë për vitin 2026 si dhe vendimit nr. 8”, drejtoria e burimeve njerëzore, informacionit dhe shërbimeve digjitale, njofton shpalljen për:

**vend të lirë pune në pozicionin: inspektor i policisë bashkiake – në drejtorinë e policisë bashkiake**

**Afati për dorëzimin e dokumenteve është deri më datën: 12.06.2026**

### **Kompetencat dhe detyrat e inspektorit të policisë bashkiake**

Inspektori i policisë bashkiake ka këto kompetenca dhe detyra si më poshtë:

- a) Inspekton veprimtarinë e policisë bashkiake në terren dhe në zyrë;
- b) Organizon, drejton, kontrollon dhe përgjigjet përpara eprorit, për sigurimin e zbatimit të detyrimeve dhe kompetencave që ka sipas ligjit;
- c) Kryen hetime në raste të veçanta sipas nevojës;
- d) Koordinon veprimtarinë e punës dhe raporton te drejtuesi i policisë bashkiake në lidhje me raportin me Policinë e Shtetit për zbatimin e detyrimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e rendit e të sigurisë publike në parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme për aktivitetet që zhvillohen në territorin e bashkisë;
- e) Monitoron zbatimin e procedurave dhe politikave të policies bashkiake;
- f) Përgatit raporte dhe rekomandime për përmirësimin e performancës së policisë bashkiake;
- g) Bashkëpunon me autoritetet e tjera për të garantuar sigurinë dhe rendin publik.

### **Kriteret për pranimin për inspektor në policinë bashkiake:**

Kandidati për pranimin në pozicionin inspektor i policicisë bashkiake duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

1. të jetë shtetas shqiptar;
2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
4. të ketë përfunduar arsimin e lartë;
5. të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;
6. ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
7. të mos jetë subjekt i ndalimeve sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike;

### **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë;

1. kërkesën;
2. jetëshkrimin;
3. fotokopjen e kartës së identitetit;
4. fotokopjet e noterizuara të diplomës të arsimit të lartë;
5. 2 (dy) foto me përmasa 4 x 6 cm;
6. raportin mjekoligjor mbi gjendjen shëndetësore (në format elektronik);
7. certifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti);
8. vërtetimin nga prokuroria për qenien ose jo në ndjekje penale;
9. vërtetimin nga gjykata për çështje në proces gjykimi;
10. dokumentet për vërtetimin e përvojës në punë apo librezën e punës (e noterizuar);
11. vlerësimin e fundit të punës, kur aplikantët vijnë nga administrata publike;
12. vërtetimin që të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
13. certifikata, trajnime profesionale, në fushën përkatëse (nëse ka);
14. fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit "B";
15. formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

***Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Himarë, brenda datës 12.06.2026.***

Në përfundim të afatit të verifikimit paraprak nga Komisioni i përzgjedhës, *drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse* do të shpallë në faqen e internetit të Bashkisë Himarë dhe në stendat e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër si dhe për datën, vendin

dhe orën e zhvillimit të procedurave. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në Bashkisë Himarë. Afati i ankimit është 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

### **Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi:**

- Njohuritë mbi ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Njohuritë mbi vendimin nr.452, datë 26.07.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullorës kuadër të policisë bashkiake”;

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Kandidatët do të vlerësohen në këto faza të konkurimit:

- **Testim me shkrim deri në 60 pikë**

Testimi me shkrim kryhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga shpallja e listës së kandidatëve, që plotësojnë kriteret ligjore për t’u pranuar në policinë bashkiake. Rezultatet e testimit me shkrim dalin brenda ditës së testimit. Kandidati nuk kualifikohet për vazhdimin e konkurrimit nëse nuk merr 60% të pikëve të përcaktuara. Kandidati që merr më shumë 60% të pikëve të përcaktuara të testimit do të do të njoftohen me anë të postës elektronike për të vazhduar procesin e intervistes.

- **Intervista me gojë deri në 40 pikë**

Intervista konsiston në testimin e aftësitëve të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime. Në këtë fazë konkurrimi, totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 40 (njëzet) pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) jetëshkrimi (CV), që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, deri në 10 pikë;
- b) intervista, deri në 30 pikë.

Rezultati i përgjithshëm i aplikantit përcaktohet si shumatore e rezultatit të testimit me shkrim dhe rezultatit të intervistës me gojë. Kandidati që merr më shumë se 60 pikë për të dyja fazat konsiderohet i suksesshëm. Kandidatët, që kanë marrë më pak se 60 pikë, renditen në një listë të posaçme që nuk bëhet publike dhe ata njoftohen individualisht nga drejtoria e burimeve njerëzore.

### **Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit:**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Himarë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për vlerësimin përfundimtar. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse në Bashkisë Himarë. Afati i ankimit është 5 ditë nga data e shpalljes dhe njoftimit të rezultateve të testimit.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

